

Njoftimi i Kualifikimit

Zhvilluesi i Projektit të Investimit:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Emri i Projektit të Investimit:	Rijetëzimi i Pallatit të Lojrave me dorë “Asllan Rusi”, Tiranë
Konkursi i projektimit:	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Korporata e Investimeve Shqiptare
Titulli i kontratës:	Projektimi dhe zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i projektit të investimit “Rijetëzimi i Pallatit të Lojrave me “Asllan Rusi”, Tiranë
Datë:	8 Gusht 2025

Ky Njoftim ju informon për rezultatet e vlerësimit të fazës së parë të procedurës konkurruese për projektin e investimit “Rijetëzimi i Pallatit të Lojrave me dorë “Asllan Rusi”, Tiranë”.

Projekt-idetë paraprahe arkitekturore të dorëzuara nga të gjithë aplikantët në fazën e parë të procedurës u vlerësuan dhe renditën sipas listës së mëposhtëme:

Renditja	Emri i Aplikantit
1.	Alko Impex Construction sh.p.k + Kengo Kuma & Associates + Seiichi Saito + Buro Happold + Ida Vako + Dhimiter Papa + Ergys Krisiko
2.	Trema Tech sh.p.k + Likado BV + Albanian Capital Group sh.p.k + BCN Investements B.V + MVRDV
3.	BAMI Holding sh.p.k. + Archea Associati S.r.l + AEI Progetti S.r.l + Arjan Coka PF + Helidon Xhixha
4.	BE-IS + Chybik + Kristof+ Mama + Loft + Destil Creative HUB
5.	PROGEEN + Sauerbruch Hutton Gesellschaft von Architekten mbH + Atelier 4 + SBP (Schlaich bergermann partner) + Gustafson Porter – Bowman + Anri Sala
5.	TABI Construction sh.p.k. + Perrault Architecture + Enea Landscape Architect + Ivan Navarro (Hueso Records) + Arup Ireland + Erald Kerluku
6.	Ales Construction + Coop Himmelb(L)au Wolf D.Prix &Partner ZT gmbh + Xplan Studio + Genc Permeti
7.	2T sh.p.k + Michan Architecture + Bezhe Design Studio + Jeshile Landscape Design+ D&C Partners
8.	Atelier Alter Architects PLLC
9.	Artan Dumi PF + Mirela Papuli PF + Rokli Construction+ Office Kersten Geers David Van Severen + Arquitectura-G + Kristi Tashi (Ne Artitektet) + Bollinger-Grohmann + Pieter Vemeersch

Sipas procedurës së përcaktuar në Dokumentin e Kualifikimit, Seksioni II – Kushtet dhe Kriteret e Kualifikimit, nën-seksioni 6, aplikantët e renditur në 5 vendet e para në procesin

e vlerësimit të projekt-ideve paraprake arkitekture, sipas renditjes së mësipërme, kualifikohen për të vijuar fazën e dytë të procedurës konkurruese.

Aplikanti “PROGEEN + Sauerbruch Hutton Gesellschaft von Architekten mbH + Atelier 4 + SBP (Schlaich Bergemann partner) + Gustafson Porter – Bowman + Anri Sala” dhe aplikanti “TABI Construction sh.p.k. + Perrault Architecture + Enea Landscape Architectt + Ivan Navarro (Hueso Records) + Arup Ireland + Erald Kerluku” janë vlerësuar me pikë të barabarta në “Listën 1 – Renditja sipas pikëzimit” dhe renditen të dy në vendin e pestë të Listës 1.

Aplikanti “Trema Tech sh.p.k + Likado BV + Albanian Capital Group sh.p.k + BCN Investments B.V + MVRDV”, **kualifikohet me kusht**, sipas pikës 22.2 të Udhëzimeve për Aplikantët, të Dokumentit të Kualifikimit. Kushti për kualifikim është dorëzimi i pasqyrave financiare për tre (3) vitet e fundit të anëtarëve bashkimit të subjekteve, të cilat **duhet të jenë të certifikuara / audituara nga një subjekt i licensuar auditimi** (për aplikantët person juridik – nëse është e aplikueshme) **brenda 20 ditëve** pune nga data e marrjes së njoftimit.

Pas kalimit të afateve të ankimimit, Korporata do tu dërgojë kandidatëve të kualifikuar Ftesën për Propozim, e cila përmban udhëzimet për kandidatët për ndjekjen e procedurës në fazën e dytë.

Transmetimi i këtij Njoftimi fillon periudhën e ankimimit për këtë fazë. Nëse një Aplikant dëshiron të bëjë një ankesë lidhur me konkurimin, Aplikanti do të paraqesë ankesën e tij me email, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e këtij njoftimi, në adresën:

Për vëmendje: Njësia e Trajtimit të Ankesave
Adresa e emailit: competition@aicorporation.al

Korporata do ti shqyrtojë ankesat në bazë të procedurës së ankimimit të përcaktuar në Rregulloren e Procedurës së Konkurimit, të publikuar në faqen e saj të internetit.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Njoftim, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni.